

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës në sigurimin e një konkurrence të lire dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar;
- Duke njohur bashkëpunimin e këtij Autoriteti me institucionet qendrore e ato rregullatore për aktet që mund të prekin funksionimin e konkurrencës në tregje;
- Duke konsideruar se mirëfunksionimi i tregjeve kërkon gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe faktorëve të tregut për t’i bërë ata konkurrues dhe sa më të hapur, me synim mirëqenien e konsumatorit,

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2020 në drejtim të:

- Angazhimit maksimal të Komisionit të Konkurrencës për zhvillimin normal të veprimtarisë së institucionit, edhe pse në kushtet e vështira të krijuara si pasojë e pandemisë Covid-19, i cili është pasqyruar në miratimin e një numri total prej 87 vendimesh.
- Monitorimit të vazhdueshëm së bashku me institucionet e tjera mbikëqyrëse të përqëndrimeve të autorizuara gjatë vitit 2019 në dy nga tregjet me impakt të drejtpërdrejtë në interesat dhe mirëqenien e konsumatorëve, siç është tregu i telefonisë celulare dhe tregu financiar, me qëllim vlerësimin e efekteve që do të sillte në treg ndryshimi I kontrollit të shoqërive respektive.
- Përfundimit të procedurave hetimore në 5 tregjet që janë hetuar gjatë vitit 2019, për të cilat ka pasur dyshime të arsyeshme apo janë konstatuar raste të marrëveshjeve të ndaluara ose abuzim me pozitën dominuese, si: tregu i shërbimeve bankare, tregu i veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit, tregu i importit të grurit dhe prodhimit të miellit, tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, tregu i depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, si dhe përfundimi i hetimit të përgjithshëm në sektorin e arsimit të lartë, shoqëruar me detyrimet dhe rekomandimet përkatëse për IAL-të publike dhe private, rekomandimet e dhëna MASR dhe INSTAT.
- Rritjes së numrit të hetimeve në tregjet tradicionale, si dhe nisjen e hetimeve në tregjet e reja shumë sensitive për publikun e gjerë, siç është tregu për shitjen me shumicë dhe pakicë të materialeve paramjekësore, kërkesa e të cilave është rritur ndjeshëm si pasojë e pandemisë.
- Përafrimit të mëtejshëm të kuadrit rregullator të konkurrencës me direktivat e BE-së, duke hartuar dhe miratuar gjatë vitit 2020 katër akte nënligjore në formën e udhëzuesit, ku ndër më kryesorit është miratimi i direktivës së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, ECN+ “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”, e cila jep sigurinë se Autoriteti i Konkurrencës ka të gjitha mjetet e duhura për zbatimin e ligjit të konkurrencës, duke ofruar garanci dhe standarde në veprimtarinë e tij, si dhe aktet e tjera që do vijnë në ndihmë të ndërmarrjeve, konsumatorëve dhe publikut në terësi për sa i takon çështjeve që lidhen me konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike, me praktikën më të mira për kryerjen e procedurave për zbatimin e dispozitave ligjore për marrëveshjet e ndaluara dhe abuzimin me pozitën dominuese në treg apo dhe implementimin e rregullave të konkurrencës që lidhen me konfidencialitetin dhe aksesin në dosjet e Komisionit.
- Dhënies së kontributit për Kuvendin dhe institucionet e tjera për sa i takon vlerësimin ligjor të akteve ligjore dhe nënligjore, ku për vitin 2020 Autoriteti ka vlerësuar në total 37 akte, nga

të cilat 3 projektligje, 4 projektakte normative, 24 akte nënligjore në tregun e energjisë, 4 akte nënligjore në sektorin e furnizimit me ujë dhe përpunimit të ujërave të ndotura si dhe Dokumentin Strategjik dhe Planin e Veprimit të AMA-s.

- Trajnimit të vazhdueshëm të stafit të realizuara në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet projekteve të BERZH dhe IPA, duke bërë të mundur zhvillimin e 12 trajnimeve brenda vendit dhe 10 trajnimeve jashtë, si dhe një pjesëmarrje aktive në organizmat ndërkombëtarë, si: UNCTAD, OECD/RCC, ICN, etj.

- Përmirësimit ndër vite të përpjekjeve të institucionit në drejtim të advokacisë përkundrejt shumë palëve në treg, si: konsumatorët, komuniteti i biznesit dhe institucionet shtetërore, ku konkretisht gjatë vitit 2020 është hartuar dhe miratuar në bashkëpunim me projektin e asistencës teknike të dhënë nga BERZH-i dokumenti “Advokacia e konkurrencës dhe strategjia e komunikimit”, realizimi në datën 5 dhjetor i “Ditës Kombëtare të Konkurrencës” dhe nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Komisionerin për të Drejtën e Infomimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Ndjekjes së 3 proceve gjyqësore gjatë vitit 2020 ku Autoriteti rezulton të jetë i paditur nga ndërmarrjet për të cilat me vendimarrje të Komisionit është konstatuar abuzimi me pozitën dominuese dhe për të cilat gjykata administrative e shkallës së parë i ka dhënë të drejtë Autoritetit.

- Dhënies së rekomandimeve konkrete për entet rregullatore dhe institucionet e administratës qëndrore, si dhe pasurimin e Platformës Parlamentare Online me këto rekomandime duke përditësuar statusin e tyre në vazhdimësi.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2021, të angazhohet në këto drejtime:

- Të vazhdojë monitorimet, hetimet dhe analizat në tregjet sensitive dhe me ndikim të drejtpërdrejtë për mirëqenien e konsumatorit, por edhe për tregjet e tjera referuar praktikave të ngjashme të vendeve të BE-së si tregu i medias audiovizive, shërbimeve portuale dhe sektori i ekonomisë dixhitale.

- Brenda vitit 2021 të paraqesë në Kuvend për amendim ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

- Të zgjerojë më tej ndërhyrjen në procesin ligjvënës duke mos u fokusuar në vlerësimin e projektit të një propozimi të ri ligjor, por edhe në vlerësimin e legjislacionit ekzistues, me qëllim evidentimin e pasojave të padëshirueshme që mund të ketë pasur një ligj, duke harmonizuar këtë ndërhyrje në nivel kombëtar dhe vendor.

- Të jetë aktiv dhe i përfshirë në advokacinë e reformave që promovojnë konkurrencën në procedurat e prokurimit publik dhe dhënies së ndihmës shtetërore, duke kontribuar drejtëpërsëdrejti në të ardhurat e kursyera që lejojnë rritje të shpenzimeve në fusha të tjera të buxhetit.

- Të organizojë më shumë trajnime/seminare në fushën e prokurimit publik për autoritet kontraktuese dhe për bashkësinë e biznesit në mënyrë që të udhëzohet drejt hartimi optimal të procedurave të prokurimit publik, për të shmangur marrëveshjen e fshehtë dhe bid rigging dhe të rritet ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e konkurrencës në prokurimin publik.

- Të krijojë mekanizma efektivë konsultimi me bizneset dhe partnerët socialë për të siguruar transparencë dhe parashikueshmëri të masave mbështetëse dhe legjislacionit në fushën e konkurrencës.

- Të rrisë përpjekjet për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës së konkurrencës me fokus të veçantë botën akademike, me synimin që të sigurojë një gjeneratë profesionistësh, të cilët do të jenë të formuar në fushën e ligjit dhe të ekonomisë së konkurrencës dhe të pajisur me dije për të trajtuar politikatat e konkurrencës dhe çështje të rregullimit.